



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

<b>DATË/A:</b>	10.07.2013
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK-DPK- 4418/12
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Shkëmb MANAJ, Drejtor i Departamentit Ligjor në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)
<b>CC:</b>	Veton FIRZI, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	OPINION për trajtim të konfliktit të interesit



Të nderuar,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, (Gazeta Zyrtare nr. 65, datë 05.02.2010) dhe nenit 19 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 dhe 1. 6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, (Gazeta Zyrtare nr. 16, datë 14.09.2011), Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

**OPINION**

Agjencia Kundër Korrupsionit ka pranuar kërkesë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me nr. të protokollit 03/1899/13, me datë 18.06.2013, me të cilën është kërkuar nga ne si autoritet kompetent për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, që të shqyrtohet situata e mundshme e konfliktit të interesit për nëpunësit civil të cilët janë të punësuar si punëtor të rregullt dhe si krijues dhe performues të kulturës si dhe për punonjësit e trashëgimisë kulturore, nëse të njëjtit mund të përfitojnë subvencione nga Ministria e Kulturës qoftë si individ ose pjesëmarrës me pagesë në realizimin e projekteve të organizatave joqeveritare.

Përmes kësaj shkrese ju njoftojmë se Agjencia kundër Korrupsionit është institucion i pavarur të cilit i janë besuar me ligj përgjegjësi të veçanta. Sipas nenit 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia është autoritet qendror e cila ndër të tjera ka kompetencë edhe mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që përbëjnë konflikt të interesit si dhe ndërmerr masat e parapara me ligj. Rrjedhimisht, çështja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është e rregulluar detajisht me Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Pas shqyrtimit të detajuar të kërkesës suaj, në pajtim me dispozitat dhe mandatin e përcaktuar ligjor, duke i marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat relevante që i posedojmë në lidhje me çështjen e konfliktit të interesit në rastin e institucionit tuaj, vlerësojmë si në vijim:

Të gjithë nëpunësit civil gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre përkatësisht detyrës zyrtare duhet të parandalojnë dhe të shmangin rastet e konfliktit të interesit, situata këto që mund të ndikojnë direkt ose indirekt në ushtrimin e funksioneve dhe në kryerjen e detyrave. Rrjedhimisht, ky detyrim ligjor për shërbyesit civil në mënyrë shprehimore është paraparë edhe me nenin 5 (paragrafi 8) të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Shërbimin Civil), i cili përcakton se nëpunësit civil nuk duhet të lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë konflikt interesi. Në çdo rast nëpunësit civil duhet të udhëhiqen nga parimi i ligjshmërisë dhe të veprojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil.

Sa i përket kërkesave për subvencionim nga nëpunësit civil të cilët kanë status të punëtorëve të rregullt në institucionin tuaj, përfshirë këtu edhe krijuesit dhe performuesit e kulturës dhe trashëgimisë kulturore, vlerësojmë se të njëjtit nuk mund të përfitojnë fonde nga ky institucion bazuar në nenin 53 (paragrafi 1) të Ligjit për Shërbimin Civil i cili përcakton se në ushtrimin e funksioneve të tyre, nëpunësit civil duhet të përkushtohen në zbatimin e ligjshmërisë dhe mbrojtjen e interesit publik dhe jo në realizimin e fitimeve personale, për individë apo organizata të tjera.

Më tej sipas zgjidhjeve të dhëna në nenin 11 (paragrafi 2) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, nëpunësit civil, në këtë rast punëtorët që punojnë si punëtor të rregullt në Ministrinë e Kulturës në cilësinë e krijuesve dhe performuesve të kulturës dhe trashëgimisë kulturore dhe aplikojnë për subvencione në këtë institucion nuk mund të përfitojnë fonde nga Ministria e Kulturës, në cilësinë e anëtarit të organizatës joqeveritare. Për më tepër kjo dispozitë në mënyrë primore përcakton se organizata joqeveritare me anëtar të organit drejtues nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të përfitoj mjetet nga buxheti i Kosovës, nëse anëtari i organit drejtues të organizatës joqeveritare në cilësinë e zyrtarit, ka ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në vendimmarrje, me rastin e vendosjes për Organizatat Joqeveritare përfituese nga mjetet e buxhetit të Kosovës.

Kjo kategori e të punësuarve nga Ministria e Kulturës realizon të ardhura të mira për punën artistik që bën sepse gradimet dhe pagat e tyre janë të rregulluara me Rregulloren nr. 05/2011 për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionale të Trashëgimisë Kulturore, (Qeveria, datë 23.06.2011). Rrjedhimisht fondet e ndara për subvencionimin e projekteve janë të destinuara për artistë që nuk janë të punësuar në Ministrinë e Kulturës, përkatësisht të cilët nuk kanë lidhje kontraktuese me Ministrinë e Kulturës, andaj çdo përkrahje financiare e projekteve të këtyre nëpunësve dëmton buxhetin dhe pamundëson realizmin e projekteve të artistëve të lirë.

Sipas nenit 4 (paragrafi 2) zyrtarët e lartë publikë konsiderohen të gjithë zyrtarët të përcaktuar me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Në lidhje me anëtarësinë e zyrtarit të lartë në organizata joqeveritare, kjo çështje është rregulluar me nenin 11 paragrafi (1 dhe 2) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku ndër të tjera përcaktohet se zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues të organizatës joqeveritare nga lëmi i veprimtarisë humanitare, të kulturës, sportit dhe të ngjashme pa të drejtë pagese, përjashtimisht kompensimit për shpenzime të udhëtimit, dhe të ngjashme.

Parimisht, sipas zgjidhjes së dhënë në nenin 11 (paragrafi 1) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues të organizatës joqeveritare nga lëmi i veprimtarisë humanitare, të kulturës, sportit dhe të ngjashme por pa të drejtë pagese, përjashtimisht kompensimit për shpenzime të udhëtimit dhe shpenzimeve të natyrës së ngjashme. Krahas ushtrimit të funksionit publik zyrtari i lartë mund të ushtroj edhe veprimtari të tjera bazuar në nenin 10 (paragrafi 2 dhe 3) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili përcakton se gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari i lartë mund të ushtrojë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarisë humanitare, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera. Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari i lartë mund të realizojë fitime në bazë të të drejtave të autorit, patentave dhe të drejtave të ngjashme.

Nga faktet e prezantuara më lart, vlerësojmë se rastet e subvencionimit të projekteve të paraqitura nga nëpunësit e Ministrisë së Kulturës përbejnë rast të konfliktit të interesit, andaj kërkohet nga institucioni juaj që të ndërmerrni të gjitha masat konform këtij opinionit dhe dispozitave ligjore në fuqi për të parandaluar dhe shmangur konfliktin e interesit në lidhje me subvencionimin e projekteve në institucionin tuaj.

Me respekt!